



**Prishtinë, 30 shtator 2011**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_380\_2011**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2, Nenin 25 dhe Nenin 30 paragrafi 3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 6, Nenin 18 paragrafi 3, nenin 24 dhe Nenin 32 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Aplikacionin për licencë prodhim të energjisë elektrike të bërë me datë 19.11.2010 nga ndërmarrja Korporata Energjetike e Kosovës –Divizioni i Gjenerimit “KEK SH.A.”-TC Kosova “A”, adresa: rruga “Nënë Tereza nr. 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,
- Dispozitat e Nenit 11 paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, Ligji Nr. 03/L-043,
- Njoftimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) Nr. ZSP-615/2011, të datës 26.09.2011 lidhur me aplikacionin e KEK-ut për Leje Mjedisore të Integruar,

**në seancën e mbajtur me datë 30 shtator 2011, nxori këtë:**

## **VENDIM**

- I. I VAZHDOHET** licenca për prodhim të energjisë elektrike Korporatës Energjetike të Kosovës – Divizioni i Gjenerimit (KEK SH.A.)-TC Kosova A, me numër licence ZRRE/Li\_05/06, për periudhën **04 tetor 2011 deri 04 tetor 2012.**
- II. Obligohet** KEK SH.A. që brenda periudhës së përcaktuar në pikën një (I) të dispozitivit të këtij Vendimi, ta siguroj nga MMPH Lejen Mjedisore të Integruar, dhe një kopje ta dërgoi në ZRRE.

## **Arsyetim**

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 19.11.2010 ka pranuar aplikacionin për vazhdim të licencës për prodhim të energjisë elektrike nga KEK Sh.a. –Divizioni i Gjenerimit”-TC Kosova “A”.
- Në Aplikacionin për vazhdim licence përveç dokumenteve/dëshmime tjera, kërkohet edhe Leja Mjedisore e lëshuar nga institucioni kompetent. ZRRE gjatë vlerësimit të Aplikacionit të korporatës në fjalë, ka vërtetuar se mungon kjo leje, andaj ka kërkuar nga KEK-u këtë dëshmi.



- KEK SH.a. ka njoftuar ZRRE-në se ka aplikuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) për Leje Mjedisore të Integruar, por pasi që është një proces mjaft i gjatë dhe i cili kërkon analizë të thellë të gjendjes teknike të impianteve të TC Kosova A , për këtë fazë nuk mund t'i sigurojë ZRRE-së Lejen e kërkuar.
- Me datë 27.09.2011 nga MMPH ka arritur Njoftimi me të cilin kjo Ministri informon ZRRE-në se janë duke e shqyrtuar kërkesën/aplikacionin e KEK-ut për Leje Mjedisore të Integruar, dhe pas se përmbushjes së kërkesave të nenit 9 të Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, do të lëshon KEK-ut Lejen Mjedisore të Integruar.
- Gjithashtu shkresa/njoftimi i MMPH i referohet Nenit 11 paragrafit 3 të Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, i cili përcakton se të gjitha impiantet ekzistuese, duke përfshirë edhe KEK-un, duhet të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji jo më larg se 31 Dhjetor 2017.
- Bazuar në këtë më lartë, shkresat tjera të bashkangjitura në Aplikacionit dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ZRRE ka vendosur që KEK-ut ti vazhdojë licencën për prodhim të energjisë elektrike vetëm për një **(1) vit**.

**III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar